



# **YOUR REFERENCES FOR TAX NEWS IN ALBANIA**

## **August, 2021**

AEcO Business Solutions has created the Tax Newsletter, covering the period from January to July 2021 with the aim of providing both local and international businesses with answers to key questions regarding tax regulations in Albania

---



## 1.

**Administrata Tatimore ka publikuar një portal të posacëm <https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al/self-care>**

Për efekt të nisjes së implementimit të Ligjit të Ri mbi Fiskalizimin, Administrata Tatimore ka lancuar portalin [self-care](https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al/self-care) në versionin Test dhe Live. Me fillimin e procesit të fiskalizimit është e nevojshme që të gjithë tatimpaguesit të kryejnë procedurat e raportimit për Fiskalizimin në këtë portal të posacëm. Versioni “test” i portalit u hap fillimisht për t’ju ardhur në ndihmë tatimpaguesve që të familjarizohen paraprakisht me sistemin dhe të kryejnë veprime testuese pa asnjë efekt në raportimin tatimor.

**Portali self-care aksesohet në linkun:** <https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al/self-care> dhe duke përdorur kredencialet e llogarisë së biznesit nga e-Albania mund të logoheni në sistem. Në portalin self-care gjenden gjithashtu [manualet](#) përkatëse të përdorimit të secilit funksionalitet të platformës së implementuar.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka ndërtuar platformën për menaxhimin e pyetjeve/ problematikave mbi procesin e Fiskalizimit në Shqipëri. Kjo platformë është funksionale që prej datës 8 Janar 2021 në linkun: <http://helpdesk.tatime.gov.al>.

**Duam të ju rikujtojmë se afatet për nisjen e implementimit të Procesit të Fiskalizimit janë:**

- a) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, efektet e këtij ligji  
➔ **kanë nisur më 1 janar, 2021.**
- b) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, efektet e këtij ligji fillojnë  
➔ **kanë nisur më 1 korrik 2021.**
- c) për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit, pavarësisht përgjegjësisë tatimore apo qarkullimit vjetor të realizuar,  
➔ **1 shtator 2021.**

Për të implementuar procesin e Fiskalizimit nevojitet paraprakisht që biznesi të disponojë:

1. Certifikatën Elektronike nga AKSHI
2. Një zgjidhje software-ike të licensuar
3. Lidhje të vazhdueshme interneti
4. Pajisje Hardware (Kompjuter/Laptop dhe Printer).



## 2.

**Nga data 1 Janar 2021 ndryshon Paga Minimale e detyrueshme për tu zbatuar nga çdo person juridik apo fizik**

Duke filluar nga **dt. 1 Janar 2021**, paga minimale në Republikën e Shqipërisë rritet nga 26,000 lekë **në 30,000 lekë** në baza mujore (sipas VKM nr. 1025, datë 16.12.2020).

Për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme **të sigurimeve shoqërore**:

- Paga Bruto mujore do të jetë minimalisht 30,000 lekë dhe maksimalisht deri në 132,312 lekë.

Për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme **të sigurimit shëndetësor**:

- *Për personal e punësuar* → Kufiri minimal i pagës do të jetë 30,000 lekë dhe nuk ka kufi maksimal
- *Për personat e vetpunësuar (dhe punonjës të papaguar të familjes)* → Kufiri minimal është sa dyfishi i pagës minimale, prej 60,000 lekë.

## 3.

**Kujtojmë të gjithë bizneset që të aplikojnë për Certifikatën Elektronike të projektit të Fiskalizimit**

Certifikata Elektronike, për projektin e Fiskalizimit është një nga elementët e domosdoshëm që shërben për të aksesuar portalin self-care dhe për të lëshuar e pranuar faturat elektronike.

Certifikata Elektronike sigurohet duke aplikuar online tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nëpërmjet portalit e-Albania, në linkun:

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=13691](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13691)

*Pajisja me certifikatën elektronike është detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji 87/2019 "Për Faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar*



# TAX CONSULTANT

## 4.

**Nga data 1 Janar 2021 ka ndryshuar fasha e tatimpaguesve që kanë detyrim për të deklaruar dhe paguar TVSH-ën**

Tatimpaguesit, me **qarkullim vjetor mbi 10 milionë lekë** kanë detyrimin për të deklaruar dhe paguar TVSH (pavarsisht nëse është i regjistruar për Tatim mbi Fitim apo Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin)

Deklarimi dhe pagesa e TVSH është me bazë mujore dhe duhet kryer brenda datës 14 të muajit pasardhës. Ndërsa deklarimi i Librave të Shitjes dhe Blerjes kanë afat deri në datën 10 të muajit pasardhës.

**Për tatimpaguesit, përfshirë profesionet e lira, të cilët kanë realizuar qarkullim me te vogel se 10 milionë lekë për vitin e plotë kalendarik 2020, do të kryhet çregjistrimi automatik i përgjegjësisë tatimore të TVSH-ës. Përgjithësisht bizneset që gjatë vitit 2020 kanë kryer të paktën një import.**

*(Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 576 datë 22.7.2020)*

## 5.

**Nga data 1 Janar 2021, tatimi mbi fitimin i barabartë me 0% për biznesin e vogël me xhiro deri në 14 milionë lekë.**

Ndryshimi i “Shkallës tatimore”, paraqitet si më poshtë me efekt prej 1 Janar, 2021:

- a) 0% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14,000,000 lekë në vit.
- b) 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14,000,000 lekë në vit.”



## 6.

### **Nga data 2 shkurt 2021, në Shqipëri ka nisur të zbatohet një legjislacion i ri që rregullon taksimin në sektorin hidrokarbur**

Regjimi i ri fiskal për sektorin e hidrokarburëve i trajton veçmas operacionet hidrokarbure nga ato jo-hidrokarbure (si dy biznese më vete).

- Tatimi mbi fitimin nga *operacionet hidrokarbure* llogaritet duke aplikuar shkallën tatimore 50% të fitimit të tatueshëm nga operacionet hidrokarbure
- Ndërsa fitimi i tatueshëm nga *operacionet johidrokarbure* llogariten dhe tatohen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat (norma tatimore 15%)

Humbjet tatimore që rrjedhin nga operacionet jo-hidrokarbure nuk mund të përdoren për të zvogëluar fitimet e tatueshme që rrjedhin nga operacionet hidrokarbure dhe anasjelltas.

#### **Si konkluzion:**

Një person që kryen operacione hidrokarbure duhet të paraqesë më vete një deklaratë tatimore për operacionet hidrokarbure të kryera nga ai dhe një deklaratë tjetër tatimore për operacionet johidrokarbure.

## Western Balkan business data at your fingertips

Realtime business intelligence from all the companies in the broader Balkan region.

Analyze complete statutory and financial information of your clients, in different languages and currencies from the **official registries in the region**

Albania



Search Companies



Search Persons

ADVANCED SEARCH

## 7.

### Prej muajit MAJ 2021 ka filluar ofrimi i shërbimeve tregtare online në platformën BIFIDEX (rajonale)

BIFIDEX (Shkëmbimi i të dhënave të biznesit dhe financare) është Portali i Regjistrave Rajonal të Biznesit, ku janë përfshirë edhe regjistrat tregtar të Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut, Mali i zi dhe Republika Srpska (Bosnja dhe Hercegovina).

Portali aksesohet në linkun në vijim: <https://www.bifidex.com/en/>,

ku të gjithë përdoruesit e jashtëm mund të kërkojnë të dhëna mbi personat juridik dhe fizik që ushtrojnë aktivitetin e biznesit në këto vende të Evropës Juglindore.





## 8.

### **Ndryshime si pjesë e paketës për mbështetjen e sportit**

- **Ulja e TVSH-ës në 6% për investimet në sport**

Në nenin 49 "Shkallët e reduktuara" të Ligjit për TVSH-ën është bërë një shtesë e re me efekt nga 1 Janari 2021, në të cilën është vendosur aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH-ës prej 6% për shërbimin e punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore ose për investimet e klubeve/federatave sportive, për infrastrukturën sportive. Furnizuesit e punimeve të ndërtimit, do të llogarisin TVSH-në në shitje prej 6% për punimet e ndërtimit për infrastrukturën sportive, por do të zbresin të plotë TVSH-në e paguar prej 20% për blerjen e mallrave dhe shërbimeve në funksion të këtyre punimeve.

- **Të ardhurat e përjashtuara**

Pagat dhe shpërblimet e çdo lloji të sportistëve, që kanë kontrata të rregullta me klubet sportive, të cilat njihen nga federatat përkatëse sportive, të **përfituara gjatë periudhës 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2022** – do të përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale (TAP).

## 9.

### **Dorëzimi i Deklaratës Individuale Vjetore e të Ardhurave (DIVA) shtyhet afati deri më 30 Qershor 2021**

Në ndryshim nga vitet e kaluara, **detyrimi** për të plotësuar dhe dorëzuar Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave ka prekur edhe **personat e punësuar në më shumë se një subjekt** (duke nisur me efekt prej vitit 2020), pavarësisht se të ardhurat bruto vjetore të tyre mund të jenë më pak se 2,000,000 lekë, siç parashikohet në Ligjin mbi të Ardhurat Personale.

Për shkak të zbatimit për herë të parë të shtesës së re në Ligjin mbi të Ardhurat Personale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vendosi të **shtyjë afatin e dorëzimit të deklaratës DIVA dhe të pagesës së TAP** nga data 20 Prill për në datën **30 Qershor 2021**.

Sanksionet administrative do të falen, me kusht që dorëzimi i deklaratës dhe pagesa e detyrimit të kryhen brenda datës 30 qershor 2021.

## 10.

### Afati i aplikimit për regjistrim në Regjistrin e Pronarëve Përfitues (RPP) përfundoi më 30 Qershor 2021

Aplikimi në Regjistrin e Pronarëve Përfitues duhet të kryhet brenda afatit 60 ditor, që prej krijimit të RPP-së sipas nenit 15, të ligjit, pasi **në të kundërt shoqërohet me penalitet dhe ndërperje shërbimi në Regjistrin Tregtar**, deri në regjistrimin e të dhënave si dhe shlyerjen e detyrimit. Afati i fundit i regjistrimit pa penalitet ishte data 30 Qershor 2021.

Regjistrimi bëhet nga personi i autorizuar (përfaqësuesi ligjor) i subjektit, nëpërmjet aplikimit nga portali e-Albania (titulli i shërbimit gjendet nën emërtimin *“regjistrim i pronarit përfitues”*).

**Pronar përfitues** është individ i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin, përmes **pronësisë direkte ose indirekte të 25 %** ose më tepër, të:

- aksioneve/kuotave;
- pjesëmarrjes në kapitalin e subjektit
- të drejtave të votimit; ose
- përfiton nga transaksionet e kryera nga subjekti në emër të tij.

Detyrimin për regjistrim e kanë subjektet e mëposhtme:

- Shoqëritë tregtare (sh.p.k., sh.a., sh.k)
- Çdo subjekt juridik i regjistruar në QKB
- Degë dhe Zyra Përfaqësimi të shoqërive të huaja
- Organizatat Jo-Fitimprurëse
- Shoqëritë e Kursim Kreditit dhe unionet e tyre
- Shoqëritë e Bashkëpunimi Bujqësor
- Përsnat juridikë/ Ndërmarrjet me aksionar të tjerë përveç organeve shtetërore të Republikës së Shqipërisë







## 11.

### **Këshilli Kombëtar i Kontabiliteti miraton disa ndryshime të SKK-ve**

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka publikuar për komente tek palët e interesit, ndryshimet e bëra në SKK-të më dt. 07.07.2021. Ndryshimet e miratuara synojnë lehtësimin në dhënien e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare për njësitë ekonomike të vogla.

Për të lexuar ndryshimet e bera mund të [klikoni këtu](#).

Afati për komente është deri në datë **10 tetor 2021**.

## 12.

### **Norma bazë e interesit mbetet e pandryshuar**

Në konferencën e Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë mbi miratimin e Raportit Tremujor të Politikës Monetare, të mbajtur më **4 Gusht 2021** u vendos:

- të lihet e pandryshuar norma bazë e interesit, në nivelin 0.5%;
- të lihen të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, përkatësisht në 0.1% dhe 0.9%.

## 13.

### **Instituti i Statistikave publikoi indeksin e çmimeve të konsumit për muajin Qershor 2021**

Në datë 8 Korrik 2021, INSTAT publikoi një deklaratë mbi Indeksin e Çmimeve të Konsumit për Qershor 2021. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një **viti më parë** kemi një rritje të indeksit të çmimeve të konsumit me **1,6 %**. **Ndryshimi mujor** i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2021, krahasuar me Maj 2021 është **-0,8 %**

Nga vrojtimi i grupeve kryesore të produkteve dhe shërbimeve të klasifikuara për efekt konsumi, në Qershor 2021, në krahasim me vitin e kaluar (Qershor 2020), është regjistruar një rritje e çmimeve për grupet “Komunikimi” (2,8%), “Ushqime dhe pije joalkoolike” (2,7%) dhe “Transporti” (2,5 %).

Krahasuar me muajin Maj 2021, u ulën çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” (-2,4%), “Veshje dhe këpucë” (-0,2%). Nga ana tjetër çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u rritën me 0,7%, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,3%, “Shëndeti”, “Transporti” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,2% secili.





## 14.

### **Mbi përdorimin e dokumentacionit tatimor gjatë fazës tranzitore të procesit të fiskalizimit**

Sipas njoftimit të bërë nga Administrata Tatimore më dt. 14 Korrik, 2021 – Tatimpaguesit që nuk janë pajisur me një zgjidhje software për të lëshuar fatura elektronike (të fiskalizuar) mund të vijojnë të përdorin dokumentacionin tatimor ekzistues deri në datën 31.08.2021.

*(tërheqja e dokumentacionit pranë Drejtorive Rajonale kryhet deri në datën 15.08.2021)*

Të gjithë tatimpaguesit të cilët rezultojnë me zbatim efektiv të procesit të fiskalizimit do të lëshojnë vetëm fatura të fiskalizura, por nëse do të kenë probleme teknike të parashikuar nga Udhëzimi Nr. 16, datë 3.4. 2020 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, do të pajisen me dokumentacion tatimor në DRT e juridiksionit.

**Për efekt të njohjes së shpenzimeve**, faturat tatimore të lëshuara në zbatim të Ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, do të vijojnë të njihen për rastet kur zbatimi i procesit të fiskalizimit nuk është zbatuar për shkaqe të pavaruara nga tatimpaguesit.

### **Administrata Tatimore njofton pezullimin e përkohshëm të sanksioneve që lidhen me procesin e fiskalizimit**

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 27 datë 01.07.2021, botuar në Fletoren Zyrtare, për një shtesë në ligjin Për Procedurat Tatimore, është shtyrë në kohë **zbatimi i sanksioneve në kuadër të Ligjit të Fiskalizimit, të cilat do të fillojnë të aplikohen pas datës 1 Janar 2022.**





## 15.

### **Mbi procedurën e fiskalizimit të deklarave të importit**

Detyrimi për fiskalizimin e faturës së importit të mallrave, përcaktohet në nenin 20, pika 7 dhe 10, të Ligjit nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Kjo procedurë duhet të kryhet jo më vonë se 3 ditë nga momenti që mallrat vendosen nën procedurën e qarkullimit të lirë nga Autoriteti doganor.

Bazuar në marrëveshjen për shkëmbim informacioni midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, informacioni për deklaratat doganore vjen i përditësuar në sistemin e Administratës Tatimore, dhe një pjesë e së cilës shfaqet në llogarinë e çdo tatimpaguesi në portalin **Self-Care**.

Procedura e fiskalizimit të faturave të huaja për mallrat e importuara është e parashikuar në nenin 25 të Udhëzimit nr. 16, datë 03.04.2020 “Për Faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, <https://www.tatime.gov.al/c/424/431/baza-ligjore>.

## 16.

### **Për raportimin e transaksioneve ndërmjet subjekteve tatimpaguese “Farmacive” me FSDKSH-në**

Sipas njoftimit të dt. 16 Korrik, 2021 nga DPT, për tatimpaguesit që tregtojnë produkte Farmaceutike është vendosur që deri në implementimin e plotë të sistemit të fiskalizimit të gjitha raportimet ditore të vazhdojnë të kryhen siç janë kryer nëpërmjet faturave përmbledhëse, por me kusht që këto fatura përmbledhëse të jenë të fiskalizuara nëpërmjet një zgjidhjeje softëare-ike të certifikuar.

Faturat përmbledhëse të muajit Korrik 2021, do të bëhen vetëm nëpërmjet zgjidhjeve software-ike të certifikuara për transaksionet pa para në dorë brenda datës 10 Gusht 2021, me përjashtim të rasteve kur procesi i fiskalizimit nuk është zbatuar për shkaqe të pavarura nga tatimpaguesit.



## 17.

### **Njoftim për çregjistrimin e pajisjeve fiskale në rast përdorimi të një zgjidhjeje softuerike**

Të gjithë tatimpaguesit, që prej momentit që zgjedhin të lëshojnë fatura për transaksionet me para në dorë nga një zgjidhje software-ike e certifikuar dhe për rrjedhojë nuk po përdorin më pajisjet fiskale të instaluara, duhet të marrin masat për të kryer procedurën e çregjistrimit të këtyre pajisjeve fiskale në përdorim.

Për të bërë çregjistrimin e kasës fiskale, subjekti duhet të dërgojë një shkresë zyrtare në Administratën Tatimor ose elektronikisht në në formë kërkesë me titull **“KËRKESË PËR ÇREGJISTRIMIN E PAJISJES FISKALE”**. Kërkesa shoqërohet me të dhënat identifikuese të zgjidhjes software-ike në përdorim ose kopje e kontratës së instalimit dhe mirëmbajtjes nga shoqëria e zgjidhjes software-ike.

## 18.

### **Mbi zbatimimin e Planit të masave për sezonin turistik 2021**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar për marrjen e masave për informimin, ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitetet në zonat turistike të Shqipërisë (bar, restorant, hoteleri etj.). Administrata Tatimore do të zhvillojë takime informuese pranë çdo Drejtorie Rajonale në këtë kuadër si dhe do të vijohet me verifikime dhe monitorime në vend, për:

- Regjistrimin e subjektit në QKB dhe në Administratën Tatimore;
- Detyrimin e mbajtjes së dokumentacioneve mbi pronësinë e mallrave gjendje apo në transport;
- Lëshimin e kuponit tatimor, apo faturë tatimore;
- Regjistrimin e punonjësve;
- Afishimi i çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve



## 1.

**Tax Administration has launched a special portal <https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al/self-care>**

As the implementation of the new Law on Fiscalization has approached, the Tax Administration has launched the [self-care](#) portal in the Test and Live version. Starting with the fiscalization process it is necessary for all taxpayers to complete the reporting procedures for Fiscalization in this special portal. The "test" version of the portal was initially opened to help taxpayers familiarize themselves with the system and perform test actions without any effect on tax reporting.

**The self-care portal can be accessed in the following link:**

<https://efiskalizimi-app.tatime.gov.al/self-care> using the business account credentials from e-Albania you can log in to the system. The self-care portal also contains the relevant [manuals](#) for the use of each functionality of the implemented platform.

- The General Directorate of Taxation has built a platform for managing questions / issues regarding the Fiscalization process in Albania. This platform is operational since January 8, 2021 at the link: <http://helpdesk.tatime.gov.al>.

**We remind you that the deadlines for the start of implementation of the Fiscalization Process are:**

- a) for transactions without cash between taxpayers and governmental bodies, the effects of this law  
➔ **already started on January 1, 2021.**
- b) for cashless transactions between taxpayers, the effects of this law begin  
➔ **already started on July 1, 2021.**
- c) for cash transactions by taxpayers, regardless of tax liability or annual turnover  
➔ **on September 1, 2021.**

In order to implement the Fiscalization process, the business needs in advance:

1. The Electronic Certificate from NAIS
2. A licensed software solution
3. Continuous internet connection
4. Computer / Laptop and Printer





## 2.

**From January 1, 2021 changes the mandatory Minimum Wage to be applied by any legal or natural person**

Starting from **January 1, 2021**, the minimum wage in the Republic of Albania increases from 26,000 ALL **to 30,000 ALL** on a monthly basis (according to DCM no. 1025, dated 16.12.2020).

For the purpose of calculating compulsory **social insurance contributions**:

- The gross monthly salary will be a minimum of 30,000 ALL and a maximum of 132,312 ALL.

For the purpose of calculating compulsory **health insurance contributions**:

- *For employed persons* → The minimum wage limit will be 30,000 ALL and there is no maximum limit
- *For self-employed persons (and unpaid family workers)* → The minimum limit is twice the minimum wage, of 60,000 ALL.

## 3.

**We remind all businesses to apply for the Electronic Certificate of the Fiscalization project**

The Electronic Certificate for the Fiscalization project is one of the necessary elements in order to access the self-care portal and to issue and receive electronic invoices.

The Electronic Certificate is obtained by applying online at the National Agency for the Information Society (NAIS) through e-Albania portal, at the link:

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=13691](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13691)

*Equipping with the electronic certificate is a legal obligation deriving from Law 87/2019 "On the Invoice and the Turnover Monitoring System", as amended*

# TAX CONSULTANT

## 4.

**From January 1, 2021 the annual taxable turnover for declaring and paying VAT has been amended**

Taxpayers with an **annual turnover of over 10 million ALL** have the obligation to declare and pay VAT (regardless of whether it is registered for Profit Tax or Simplified Profit Tax).

The declaration and payment of VAT is on a monthly basis and must be done within the 14th of the following month. While the declaration of Sales and Purchase Books have a deadline until the 10th of the following month.

**For taxpayers, including free professions, who have realized a turnover of less than ALL 10 million** for the full calendar year 2020, the automatic deregistration of VAT tax liability will be performed. Excluded are businesses that during 2020 have performed at least one import.

*(Decision of the Council of Ministers no. 576 dated 22.7.2020)*

## 5.

**From January 1, 2021, the profit tax equal to 0% for small business with a turnover of up to 14 million ALL.**

The changes in the "Tax Rate" is presented as follows, with effect from January 1, 2021:

- a) 0% for taxpayers with incomes up to 14,000,000 ALL per year.
- b) 15% for taxpayers with incomes over 14,000,000 ALL per year. "



## 6.

**From February 2, 2021, in Albania has started to be implemented a new legislation that regulates the taxation in the hydrocarbon sector**

The new fiscal regime for the hydrocarbon sector treats hydrocarbon operations separately from non-hydrocarbon ones (as two separate businesses).

- Profit tax from petroleum operations is calculated by applying the tax rate of 50% of taxable profit from petroleum operations
- While taxable profit from non-petroleum operations are calculated and taxed according to the provisions of applicable legislation on income tax (tax rate 15%)

Tax losses arising from non-petroleum operations cannot be used to reduce taxable profits arising from petroleum operations and vice versa.

**As a conclusion:**

A person performing hydrocarbon operations must file a separate tax return for the hydrocarbon operations performed by him and another tax return for non-hydrocarbon operations.



## Western Balkan business data at your fingertips

Realtime business intelligence from all the companies in the broader Balkan region.

Analyze complete statutory and financial information of your clients, in different languages and currencies from the **official registries in the region**

Albania



Search Companies



Search Persons

ADVANCED SEARCH

## 7.

**From May 2021, the provision of online trading services on the BIFIDEX platform (regional) has started**

BIFIDEX (Business and Financial Data Exchange) is the Portal of the Regional Business Registers, which includes the trade registers of Albania, Serbia, Northern Macedonia, Montenegro and Republika Srpska (Bosnia and Herzegovina).

The portal is accessed at the following link:

<https://www.bifidex.com/en/>, where all external users can search data on legal and physical persons conducting business in these countries of Southeast Europe.



## 8.

### Amendments as part of the sports' support package

- **VAT Reduction to 6% for investments in sports**

In Article 49 "Reduced rates" of the Law on VAT a new addition has been made with effect from January 1, 2021, in which is decided the application of a reduced VAT rate of 6% for the service of construction works for state investments or for investments of sports clubs/federations, for sports infrastructure. Suppliers of construction works will calculate the VAT on sales of 6% for construction works for sports infrastructure, but will fully deduct the VAT paid of 20% for the purchase of goods and services in function of these works .

- **Exempt Income**

Salaries and bonuses of all types of athletes who have regular contracts with sports clubs, which are recognized by the respective sports federations, **received during the period 1 January 2021 to 31 December 2022 - will be exempt from personal income tax (PIT).**

## 9.

### The submission of the Personal Income Statement (DIVA) is postponed until June 30, 2021

Unlike previous years, the **obligation** to complete and submit the Individual Annual Income Statement has also affected **persons employed in more than one entity** (effective from 2020), despite the fact that their gross annual income may be less than 2,000,000 ALL, as provided in the Law on Personal Income.

Due to the implementation for the first time of the new addendum to the Law on Personal Income, the General Directorate of Taxation decided **to extend the deadline for submission of the DIVA declaration and payment of PIT from April 20 to June 30, 2021.**

The administrative sanctions will be forgiven, provided that the submission of the declaration and the payment of the obligation are completed by June 30, 2021.

## 10.

### **The application deadline for registration in the Register of the Beneficiary Owners (RPP) ended on June 30, 2021**

The application in the Register of Beneficiary Owners must be completed within 60 days, from the creation of the Register according to Article 15 of the law, as otherwise it is accompanied by penalties and service interruption in the Business Register, until the registration of necessary data and payment of the obligation. The deadline for registration without penalty was June 30, 2021.

The registration is done by the authorized person (legal representative) of the subject, through the application from the e-Albania portal (the title of the service is under the name "*registration of the beneficiary owner*").

**Beneficiary owner** is the individual who owns or ultimately controls the entity, through **direct or indirect ownership of 25% or more**, of:

- *shares / quotas;*
- *participation in the capital of the entity;*
- *voting rights; or*
- *benefits from transactions carried out by the entity on its behalf.*

The following entities have the obligation to register:

- Trade Companies (l.t.d, l.l.c., j.s.c)
- Any legal entity registered in the NBC
- Branches and Representative Offices of foreign companies
- Non-Profit Organizations
- Savings and Credit Associations and their unions
- Agricultural Cooperative Societies
- Legal entities / Enterprises with shareholders other than state bodies of the Republic of Albania







## 11.

### **The National Accounting Council approves some amendments to the NAS**

The National Accounting Council has published for comments to stakeholders, changes made to NAS, on 07.07.2021. The adopted amendments are intended to facilitate the disclosure of financial statements to small entities.

The approved amendments can be [read here](#).

The deadline for comments is **October 10, 2021**.

## 12.

### **The base interest rate remained unchanged**

At the conference of the Supervisory Council of the Bank of Albania on the approval of the Quarterly Monetary Policy Report, held on **August 4, 2021**, it was decided:

- the base interest rate to be left unchanged at 0.5%;
- the interest rates on overnight deposits and loans to be left unchanged at 0.1% and 0.9%, respectively

## 13.

### The Institute of Statistics published the [consumer price index for June 2021](#)

On July 8, 2021, INSTAT published a statement on the Consumer Price Index for June 2021. Compared to the same period **a year ago**, the consumer price index have increased by **1.6%**.

Prices of goods and services of personal consumption in June 2021, on average decreased by **0.8% compared to May 2021**.

Observed by the the main groups of products and services classified according to the purpose of consumption in June 2021, compared to the previous year (June 2020), an increase in prices was recorded for the groups "Communication" (2.8%), Food and non-alcoholic beverages" (2.7%) and "Transport"(2.5%).

Compared to May 2021, a decrease in prices was recorded for the group "Food and non-alcoholic beverages" (-2.4%) and "Clothing and footwear" (-0.2%). On the other hand, the prices of the group "Entertainment and culture" increased by 0.7%, followed by the groups "Alcoholic beverages and tobacco" by 0.3%, "Health", "Transport" and "Hotels, cafes and restaurants" by 0.2% each.





## 14.

### **On the use of tax documentation during the transitional phase of the fiscalization process**

According to the announcement made by the Tax Administration on July 14, 2021 - Taxpayers who are not equipped with a software solution to issue electronic invoices (fiscalized) can continue to use existing tax documentation until 31.08.2021.

*(withdrawal of documentation at the Regional Directorates is done until 15.08.2021)*

All taxpayers which have effectively implemented the fiscalization process will issue only fiscalized invoices, but if they have technical problems provisioned in the Instruction no. 16, dated on 03.04.2020 "On the electronic invoice and the turnover monitoring system", as amended, will be equipped with tax documentation near the Tax offices of their jurisdiction.

**For the purpose of recognition of expenses**, tax invoices issued in accordance to the Law No. 87/2019 "On the invoice and turnover monitoring system", as amended, as well as Law No. 92/2014 "On value added tax in the Republic of Albania", as amended, will continue to be deductible in the cases when the fiscalization process is not working properly, independent from the taxpayers' reasons.

### **The Tax Administration announces the temporary suspension of sanctions related to the fiscalization process**

Through Normative Act no. 27 dated 01.07.2021, published in the Official Gazette, for an addition to the law on Tax Procedures, **the implementation of sanctions under the Law on Fiscalization has been postponed, and will start to be applied after January 1, 2022.**





## 15.

### **On the procedure of fiscalization of import declarations**

The obligation for fiscalization of the invoice for the import of goods is defined in article 20, point 7 and 10, of Law no. 87/2019 " On the electronic invoice and the turnover monitoring system ".

This procedure must be completed no later than 3 days from the moment the goods are placed under the free circulation procedure by the Customs Authority.

Based on the information exchange agreement between the General Directorate of Taxation and the General Directorate of Customs, the information on customs declarations is updated in the Tax Administration system, and part of which appears in the account of each taxpayer on the **Self-Care** portal.

The procedure of fiscalization of foreign invoices for imported goods is provided in Article 25 of Instruction no. 16, dated 03.04.2020 "On the electronic invoice and the turnover monitoring system",

<https://www.tatime.gov.al/c/424/431/baza-ligjore>.

## 16.

### **For transactions reporting between taxpayers "Pharmacies" with FSDKSH**

According to the announcement dated on July 16, 2021 by the GDT, for taxpayers who trade Pharmaceutical products it is decided that until the full implementation of the fiscalization system all daily reporting will continue to be performed as usually done through summary invoices, but to be provided that these summary invoices are fiscalized through a certified software solution.

Summary invoices for July 2021 will be made only through certified software solutions for cashless transactions by August 10, 2021, unless the fiscalization process has not been implemented for reasons independent of taxpayers.



## 17.

### **Notice of deregistration of fiscal equipment in case of using a software solution**

All taxpayers, from the moment they choose to issue invoices for cash transactions from a certified software solution and consequently are no longer using the installed fiscal equipment, should take measures to carry out the procedure of deregistration of these fiscal equipment in use.

To deregister the fiscal cash register, the entity must send an official letter to the Tax Administration or electronically in the form of a request entitled **"REQUEST FOR DE-REGISTRATION OF FISCAL EQUIPMENT"**. The request is accompanied with the identification data of the software solution in use or a copy of the installation and maintenance contract from the software solution company.

## 18.

### **On the implementation of the Plan of measures for the tourist season 2021**

The General Directorate of Taxation has announced the planning of measures for information, awareness and sensibilization of taxpayers operating in touristic areas of Albania (bar, restaurant, hotel accomodation, etc.). The Tax Administration will hold informative meetings with each Regional Directorate in this framework and will continue with verifications and monitoring of below issues:

- Registration of the subject in the NBC and Tax Administration;
- Obligation to keep documentation on the ownership of goods in stock or in transport;
- Issuance of tax coupon or tax invoice;
- Employee registration;
- Keeping in plain sight the list of selling prices of goods or services



## **CONTACT**

### **AEcO Business Solution**

Ibrahim Kodra str.  
Bld. Hawai 2, Entr 1, Ap.18, 3rd floor

+355 68 403 9794

Tirane, Albania

### **Eriona Dobrovoda**

[edobrovoda@aeco-consulting.com](mailto:edobrovoda@aeco-consulting.com)

[www.aeco.al](http://www.aeco.al)

This material has been prepared for general information purposes only and is not intended to be relied upon as accounting, tax, or other professional advice. Please refer to our advisors for specific advice.